



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:163347

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589043

Ac.nr.4028/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit G.S. nga Gjilani, lagjja “A”, nr..., kundër debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, në procedurën e përmbarimit sipas dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.2966/20 të datës 13.05.2022, jashtë seance me dt. 17.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, NDRYSHOHET pjesërisht Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.2966/20 të datës 13.05.2022, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: PRANOHET pjesërisht i bazuar i prapësimi i debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, SHFUQIZOHET (vihet jashtë fuqie) pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.1046/20 të datës 03.11.2020 i lëshuar nga përmbaruesi privat E.M. në Prishtinë në shumën prej 14,853.53 Euro, ndërsa propozimi për përmbarim i kreditorit G.Sh nga Gjilani për këtë pjesë *refuzohet i pabazuar*.

II. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, MBETET NË FUQI pjesa tjetër e urdhrin përmbarimor P.nr.1046/20 të datës 03.11.2020 i lëshuar nga përmbaruesi privat E.M. në Prishtinë, për dëmin e pësuar në shumë prej 11,800.00 Euro.

III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2966/20 të datës 13.05.2022, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përbarimit Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin mbi caktimin e Përbarimit P.nr.1046/20 të datë 03.11.2020 i organit përbarues-përbaruesit privat E.M..

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori duke e atakuar të njëjtin, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta pezulloj procedurën përbaruese ashtu që të shtyhet përbarimi deri në vendosje në procedurën kontestimore nga Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me revizionin e ushtruar.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori G.Sh nga Gjilani me datë 03.11.2020, ka paraqitur propozim për përbarim, ndaj debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 805/2013 të dt. 08.12.2016, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë AC.nr.1461/17 të datës 28.07.2020, për shumën e përbarimit prej 26,653.53 Euro.

Përbaruesi Privat E.M. në Prishtinë, duke vepruar në bazë të propozimit për përbarim të kreditorit ka lejuar përbarimin me urdhrin përbarimor P.nr.1046/20 të datës 03.11.2020, duke vlerësuar se i njëjti i plotëson kushtet si vendim përbarues.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit debitori ka paraqitur prapësim me datën 10.11.2020, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin e lejuar, duke i propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të bëhet shtyrja e përbarimit të aktgjykimit me arsyetimin se i njëjti ka ushtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 12.11.2020, me të cilën i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e palës debitore të paraqitura në prapësim, e duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin e përbaruesit privat ta lejë në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2966/20 të datës 13.05.2022, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se pas shqyrtimit të prapësimit, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitori i përmbarimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Ka shtuar se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore sipas neneve 21, 22 par.1 pika 1.1, 24 par.1 dhe 2, dhe 27 par.1 të LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Dispozita e nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/I-139 për Procedurën Përmbarimore përcakton se: “dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese”. Me dispozitën ligjore të nenit 71 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, si njëri ndër shkaqet e prapësimit parashihet edhe nëse: “dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”.

Në rastin konkret pala debitore e ka njoftuar gjykatën se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.667/20 të datës 22.03.2022 është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1461/17 i datës 28.07.2020 ashtu që atje paditësit – këtu kreditorit G.Sh. në emër të kompensimit të demit jomaterial në vend të shumës së gjykuar prej 16,000.00 Euro i gjykohet shuma prej 11,800.00 Euro, nga çka rezulton se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi është ndryshuar, andaj edhe në rastin konkret kjo gjykatë vlerëson se urdhri përmbarimor P.nr.1046/20 të datë 03.11.2020 i lejuar në bazë të atij dokumenti përmbarimor duhet të shfuqizohet pjesërisht për shumën prej 14,853.53 Euro dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekt juridik për këtë shumë, ndërsa për shumën prej 11,800.00 Euro urdhri P.nr.1046/20 të datë 03.11.2020 mbetet në fuqi dhe si i tillë prodhon efekt juridik.

Titulli përmbarues është ai mbi bazën e të cilit inicohet procedura e përmbarimit dhe realizohet kërkesa e përmbajtur në të. Gjykata e Apelit vlerëson se në rrethana të tilla aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet ndërsa urdhri përmbarimor P.nr.1046/20 të datës 03.11.2020 për shumën prej 14,853.53 Euro duhet të shfuqizohet ngase nuk ka kushte ligjore të lejohet përmbarimi nga gjykata e shkallës së parë kjo pasi që dokumenti/ aktgjykimi në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore dhe është lejuar përmbarimi është ndryshuar dhe për

këtë pjesë dokumenti nuk është i përshtatshëm për përmbirim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 22 par.1 pika 1.1 të LPP – së, ndërsa për shumën prej 11,800.00 €uro urdhri P.nr.1046/20 të datë 03.11.2020 mbetet në fuqi dhe si i tillë prodhon efekt juridik.

Nga këto arsye, Gjykata e Apelit vlerëson ndryshe provat nga shkresat e lëndës dhe gjenë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu siç është përcaktuar me nenin 209 pika c) lidhur me nenin 17 të LPP-së, andaj edhe vendosi si në pikën I (një) dhe II (dy) të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 208 dhe 209 par. 1, pika c) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4028/2022, me datë 17.04.2024.

Gjyqtarja,
Halide Reka, d.v.